[Shqiptarja.com]

E diel 3 Nëntor 2024 - Përditësimi i fundit 22:50

Kërko

Live Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet me të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Gjermani i riu shqiptar vetëvritet në banesë! Babai apel për ndihmë pas kthimit e njoftit në dëfte: Pronari nuk i jepte pagesën

2 Votat e diasporës pritet të përcaktojnë emrin e presidentit në Moldavi! Kandidati prorusi me avantazh me 0,5%

3 Qeveria hedh pas konsultim Projektligjin për ndërtesat e reja - Ministrja Manko e njoftoi ekstabanen: Duhet të jenë pa emetime që nga 2028 (DOKUMENTI)

4 Itali/ I skedoar që nga 1996, shqiptari kapet duke jëgarduar mbi 1 kilo kokenë e drogës! Grupi ndërkombëtar policët, hanxi denin hapur kur doli për të dëshmuar qenin (EMRI)

5 Greqi/ Tërmet me magnitudë 5.3 në Selanik, ja ku ishte epicentroi

Kronikë

Mirditë/ Me pistoletë me fishek në fole, kapet 29-vjeçari nga Nikla me dy emra, po arratisej drejt Italisë! Në kërkim për dhunimin e gjobitjen e pronarit të një karburanti (VIDEO+EMRI)

Policia lokalizoi dhe prangosi të kërkuarin me dy identitete, i dënuar më parë në Itali për grabitje. 29-vjeçari akuzohet për krime kundër personit, armëmbajtje pa leje dhe kanosje për dhënie pasurie. bashkë me një shok rrahu dhe gjobiti pronarin e një karburanti në "Rrugën e Kombit" më 15 Tetor, kurse në muajin Gusht qëlloi me armë makinën e një turisteve rumune në fshatin Dukagjin i Ri, në Fushë-Krujë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
3 Nëntor, 10:21 | **Përditësimi: 3 Nëntor, 16:35**

Share

LEZHË- Një 29-vjeçar nga Nikla e Fushë-Krujës, i shpallur në kërkim për krime kundër personit, armëmbajtje pa leje dhe kanosje për dhënie pasurie, është arrestuar dot (3 nëntor) në Mirditë.

Aleksandër Senaj (Ndoj) po përgatitej për t'u larguar ilegalisht drejt Italisë, teksa cilësohej edhe person me rrezikshmëri të lartë kriminale, i proceduar brenda dhe jashtë vendit, teksa qarkullonte me pistoletë në brez dhe me fishekun e saj në fole, gati për qitje.

Ai kishte edhe dy vepra të tjera penale, nga të cilat një me masë sigurie "arrest me burg". Më 15 Tetor ka dhunuar në bashkëpunim me një shokun e tij, në kërkim, pronarin e një karburanti në "Rrugën e Kombit" në Mirditë, me qëllim pagesën, kurse në muajin gusht ka qëlluar me armë drejt makinës në të cilën udhëtonte një shtetase rumune, fatmirësisht pa shkaktuar lëndime.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
'Riaktivizohet' marrëveshja! Gjadri do presë emigrantë 'të sigurt'

Ndoj sipas policiase, po përpiqej të arratisej drejt Italisë, kur u lokalizua dhe ndalua. Ai ka qenë i dënuar edhe në Itali për akuzën e grabitjes. Operacioni është koduar "The End", (Fundi).

Njoftimi i policisë:

"Finalizohet operacioni policor i koduar "THE END", për kapjen e një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Operacioni nga Komisariati i Policisë Mirditë, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale në Departamentin e Policisë Kriminale në DPPSH dhe shërbimet operacionale të DVP Lezhë, nën drejtimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Kapet dhe vihet në pranga një 29 vjeçar i kërkuar për krime kundër personit, armëmbajtje pa leje dhe kanosje për dhënie pasurie. Në momentin e lokalizimit dhe kapjes, forcat operacionale i gjetën 29 vjeçarit një armë zjarri pistoletë me fishk në fole gati për qitje. Në kuadër të procedimit penal të vitit 2024, të nisur nga Komisariati i Policisë Mirditë, bazuar në informacionet e grumbulluara përgjatë hetimit dhe inteligjencës policore, u organizua dhe finalizua me sukses operacioni, ku u bë e mundur lokalizimi dhe arrestimi i shtetasit të shpallur në kërkim, (person me rrezikshmëri të lartë shoqërore):

Aleksandër Senaj Alias A.N, 29 vjeç, banues në Dukagjin i Ri, Thumanë, Krujë, i dënuar më parë në shtetin Italian për vjedhje me armë. Ky shtetas po përgatitej për tu larguar në mbrëmje ilegalisht drejt Italisë. Gjatë operacionit, në momentin e kapjes, shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale këtij shtetasi i gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 1 (një) armë zjarri pistoletë Bereta, me fishek në fole gati për qitje por nuk ka mundur dot të reagojë pasi ndërhyrja e shërbimeve të Policisë ka qenë e befasishme dhe e shpejtë.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Mirditë për veprat penale të "Shtrëngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie", "Plagosje e lehtë me dashje" e kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake", në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datë 15.10.2024. 29 vjecari në bashkëpunim me shtetasin K.B alias K.M, (i cili aktualisht ndodhet në Itali dhe është shpallur në kërkim) në ambientet e një subjekti privat (karburant), në rrugën e Kombit në Mirditë, kanë goditur me sende të forta dhe kanosur me armë zjarri për dhënie pasurie pronarin e këtij subjekti shtetasin A.Xh.

Gjithashtu ndaj shtetasit Aleksandër Senaj, alias A.N, në shtator 2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në Burg", në mungesë, për veprat penale të "Vrasjes me paramendim" e ngelur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të zjarrit dhe municioneve luftarak", pasi: Më datë 11.08.2024, në vendin e quajtur Dukagjin i Ri, Krujë, ku ky shtetas ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të një automjeti me të cilin udhëtonte një shtetase rumune. Materialet procedurale u referuan në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme".

Sl.E./A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Lezhë mirditë Aleksandër Senaj Aleksandër Ndoj nikla Fushë-krujë grabitje gjobevenie

Komento

Komente

Mamurras: 03/11/2024 16:16

Pa merak se kshu siq ja ke nis se ke te gjat dhe ti se ske mi dhan dum se pri kuj ka me te ardh

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Sipas jush, kush mund ta ndihmojë më shumë Shqipërinë në rast fitoreje?

Kamala Harris | Donald Trump | Nuk e di

Lajme të tjera

Përplasi për vdekje këmbësorin në aksin Milot-Morinë, arrestohet 24 vjeçari nga Kosova
2 Nëntor, 11:47

Marrëveshja/ Nga e hëna rinis operacioni, emigrantët nga 'vendet e sigurta' do të akomodohen në Shqipëri
2 Nëntor, 08:05

Festa/ Fëmijët e Lezhës u thonë jo maskave të frikshme, vishen si ëngjej dhe shenjtorë
1 Nëntor, 15:27

Vrasja e Ardian Nikulajt, Gjykata e Lezhës lë në qeli portugezin Ruben Saraiva! Avokati: Të zbardhen mesazhet në Encrochat (VIDEO)
1 Nëntor, 10:45

Spanjë/ Ja si do e grabiste grupi shqiptaro-spanjoll depon e floririt dhe diamanteve në Madrid! Hapën vrimë gati një metra në mur
31 Tetor, 20:09

Itali/ Dhunuan në grabitje 46-vjeçarin në rrugë, arrestohen shqiptari dhe kosovari
30 Tetor, 20:20

Protesta e opozitës, disa të shoqëruar edhe në Lezhë pasi bllokuan rrugën në Milot
30 Tetor, 11:53

Rriten kërkesat për strehim social në Lezhë, miratohet plani 5-vjeçar për t'iu ardhur në ndihmë familjeve në nevojë

Elvis Hila

30 Tetor, 10:19

Spanjë/ Po grabisnin depozitën e arit të një kompanie në Madrid, arrestohen 2 'skifterët' shqiptarë! Banorët i spiunuan, hapën vrimë në mur
29 Tetor, 22:41

Tkurren protestuesit te rrethrrotullimi i Milotit, nisin të largohen! Qytetarët: Protestojmë për vjedhjet e qeverisë dhe arrestimin e Sali Berishës!
29 Tetor, 19:28

Rrethrrotullimi i Milotit, nis djegia e gomave! Nuk mungon as 'oxhaku me dru' në mes të asfaltit, protestuesi duke ngrënë dhe pirë: Rama ik, kriminel!
29 Tetor, 18:25

VIDEO/Protesta e opozitës, digjen goma dhe në hyrje të autostradës në Fushë Milot
29 Tetor, 18:08

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje